



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 92

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

Prishtinë, më 12 shkurt 2014, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca dhe Gëzim Kelmendi.

Mungoi: Faton Topalli.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, kordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.02.2014
3. Shqyrtimi i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 5.2.2014

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 5.2.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Fikrim Damka – Tha se Komisioni këtë Projektligj e ka përfunduar para tre muajsh, dhe e ka dërguar te Komisionet kryesore. Dy nga Komisionet kryesore ai për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk e kanë kthyer raportin për këtë projektligj.

Kemi pasur takim edhe me përfaqësuesit e Zyrës së BE , për këtë Projektligj dhe për disa çështje që ata i kanë propozuar jemi pajtuar e për disa jo. Jemi pajtuar që shprehja „ Persona të dhunuar gjatë luftës “ të zëvendësohet me shprehjen, „ Viktima të dhunës seksuale gjatë luftës ”, por nuk jemi pajtuar që të ndryshoj data , apo periudha e luftës.

Si kemi diskutuar edhe në mbledhjet e kaluara , ne do ta përcjellim Projektligjin për miratim në seancë , me kërkesën drejtuar kryesisë që Projektligji të radhitet për shqyrtim në seancë pa raportin e dy komisioneve kryesore , pasi kemi pritur mjaft. Hap diskutimin.

Time Kadrijaj – Tha se me ndryshimin e propozuar nga zyra e BE së , ta procedojmë ligjin në seancë.

Flora Brovina – Tha se pajtohet që Projektligji duhet të përcillet për miratim në seancë plenare.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri miratoi raportin përfundimtar me amendamente për Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, dhe e procedoj për miratim në seancë plenare .

4. Të ndryshme

Kryetari – A ka dikush diçka për të shtuar tek pika të ndryshme? Pasi nuk ka, atëherë e mbyllim takimin, faleminderit të gjithëve.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka